

VENDIM
Nr. 244, datë 21.4.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2021,
PËR BASHKËSITË FETARE, QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME
KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, 4, 5 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 113 000 000 (njëqind e trembëdhjetë milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2021, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 33 120 000 (tridhjetë e tre milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 13 320 000 (trembëdhjetë milionë e treqind e njëzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 74 (shtatëdhjetë e katër) punonjës të administratës;

ii. 19 800 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 110 (njëqind e dhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 26 640 000 (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 20 700 000 (njëzet milionë e shtatëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) punonjës të administratës;

ii. 5 940 000 (pesë milionë e nëntëqind e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 33 (tridhjetë e tre) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 26 640 000 (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 6 120 000 (gjashtë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 34 (tridhjetë e katër) punonjës të administratës;

ii. 20 520 000 (njëzet milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 114 (njëqind e katërmëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 26 600 000 (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 5 040 000 (pesë milionë e dyzet mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 28 (njëzet e tetë) punonjës të administratës;

ii. 14 560 000 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për ndërtimin e teqesë së Elbasanit;

iii. 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit. Shuma të përdoret për të

mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2021, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të bëhet njëherësh, brenda muajit prill të vitit 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama